



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e zhvilluar më 13 korrik 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës dhe diskutoi çështjet e rendit të ditës në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori këto vendime:

Miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) për muajin qershor 2026, në vlerën 12.94 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Vendosi rinovimin e licencave të shoqërisë “ALBESP TRADING & CONSULTING” sh.p.k. në veprimtaritë e furnizimit dhe tregimit të energjisë elektrike.

Vendosi zgjatjen me 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes së Bordit për kërkesat për licencim të:

“DOMA GROUP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vinjulli 1”, me vendndodhje në përroin e Varroshit, Manadresë dhe Lajthit, degë e përroit të Zallit të Madh, Bashkia Mat, Qarku Dibër;

“GLOBAL INTERPRISE GROUP” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Doma”, me kapacitet të instaluar 1.695 MW, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e lumit Mat, Bashkia Klos, Qarku Dibër.

Miratoi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga një impiant fotovoltai me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, duke përfshirë edhe veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit. Gjithashtu, u miratua fillimi i procedurës për licencimin e këtij subjekti në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

Miratoi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve të paluajtshme, si garanci për shlyerjen e detyrimeve ndaj Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.

Miratoi ndryshime në vendimin e licencimit të shoqërisë “DION ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW. Këto ndryshime pasqyrojnë përmbushjen e kushtit të vendosur në vendimin e licencimit, lidhur me depozitimin brenda afatit të dokumentacionit përkatës të testimit të veprës.

Vendimet e plota të Bordit publikohen në faqen zyrtare të ERE-së, www.ere.gov.al, si dhe në Fletoren Zyrtare.